

Gen-I Tirana Sh.p.k
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA:

Pasqyrat financiare të konsoliduara:	Faqe
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016	4
Pasqyra e konsoliduar e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	5
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	6
Pasqyra e konsoliduar e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	7
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara	8-23



Deloitte.

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit.
Pallati poshte Fakulteti
Gjeologji- Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtuesve të Shoqërisë Gen I Tirana Sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat e konsoliduara financiare të Gen I Tirana Sh.p.k (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016 dhe pasqyrën e konsoliduar të performancës financiare, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital neto dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2016 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave të konsoliduara financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave të konsoliduara financiare në përputhje me SKK-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brëndshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontroleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese, si dhe nëse transaksionet dhe ngjarjet në pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Deloitte Audit Albania sh.p.k


Rr. Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera

Tirana, Albania

Identification number (NUIS): L41709002H

Auditues ligjor

Nuriona Berdica Sokoli



Tiranë, Shqipëri

30 mars 2017

	Shënime	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Aktivët			
I. Aktivët afatshkurtra			
Mjete monetare	4	236,011,584	4,475,605
Llogari të arkëtueshme	5	321,807,078	2,204,004,715
Tatim fitim i arkëtueshem	6	63,921,897	81,283,585
TVSH e arkëtueshme	6	497,020,386	338,959,044
Shpenzime të shtyra	6	21,168,808	24,124,513
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,139,929,753	2,652,847,461
II. Aktivët afatgjata			
Licencë	7	-	68,803
Mjete dhe Pajisje	7	16,543	22,058
Mobilje zyre	7	277,946	347,433
Aktive të tjera afatgjata	7	34,414	43,017
Totali i aktiveve afatgjata		328,903	481,310
Totali i aktiveve		1,140,258,656	2,653,328,771
Detyrimet dhe Kapitali			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	8	1,054,932,602	2,251,652,196
Të pagueshme ndaj personelit	9	18,871,671	18,979,473
Të pagueshme ndaj shtetit	10	330,681	344,684
Të pagueshme ndaj degës Kosovë		496,353	421,455
Hua nga Gen-I d.o.o		-	204,547,200
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,074,631,307	2,475,945,008
II. Detyrime afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		1,074,631,303	2,475,945,008
III. Kapitali			
Kapitali aksionar	11	6,050,000	6,050,000
Rezerva rivlerësimi		20,564	11,414
Fitimi i mbartur		8,200,000	8,200,000
Fitimi periudhës		51,356,785	163,122,349
Totali i kapitalit		65,627,349	177,383,763
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		1,140,258,656	2,653,328,771

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 u aprovuan më 28 mars 2017 dhe u nënshkruan si më poshtë:



Z. Igor Koprivnikar Përfaqësues Ligjor

gen-i 03

GEN-I Tirana Sh.p.k.
Balkan Business Center
Rr. Ismail Gema, Nr. 27, Tirana, Albania
Unique identification no.: KB1413005A

Të ardhurat nga aktiviteti	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga shitja e energjisë	12	2,727,338,943	5,249,967,776
Të ardhura të tjera	13	3,833,892	18,394,870
		2,731,172,835	5,268,362,646
Shpenzime operative			
Materiale të konsumuara	14	(2,645,672,607)	(5,161,806,970)
Shpenzime personeli		(10,488,944)	(11,497,463)
-Pagat e personelit	15	(9,775,394)	(10,765,818)
-Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	15	(713,550)	(731,645)
Amortizimi i aktiveve afatgjata	7	(152,409)	(212,046)
Rimarrje e provigjioneve / (Shpenzime)	16	(4,907)	97,773,509
Shpenzime të tjera	17	(18,792,183)	(19,285,996)
Totali i shpenzimeve operative		(2,675,111,050)	(5,095,028,965)
Fitimi nga veprimtaria operative		56,061,785	173,333,681
Shpenzime nga interesi	18	(234,029)	(388,531)
Të ardhura nga kursi i këmbimit	18	4,678,880	1,759,449
Fitimi i periudhës		4,444,851	1,370,918
Fitimi para tatimit		60,506,636	174,704,599
Tatimi mbi fitimin	19	(9,149,851)	(11,582,250)
Fitimi i vitit	19	51,356,785	163,122,349

Pasqyra e konsoliduar e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.


Z. Igor Koprivnikar
Përfaqësues Ligjor

GEN-I Tirana Sh.p.k**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)*

	Kapitali	Rezerva nga konvertimi i monedhave të huaja	Fitime të akumuluar	Totali
Më 31 dhjetor 2014	6,050,000	376	66,925,175	72,975,551
Dividend të paguar	-	-	(58,725,175)	(58,725,175)
Diferenca në këmbim	-	11,038	-	11,038
Fitimi i vitit	-	-	163,122,349	163,122,349
Më 31 dhjetor 2015	6,050,000	11,414	163,122,348	177,383,763
Diferenca në këmbim	-	9,150	-	9,150
Dividendë të paguar	-	-	(163,122,349)	(163,122,349)
Fitimi i vitit	-	-	51,356,785	51,356,785
Më 31 dhjetor 2016	6,050,000	20,564	59,556,785	65,627,349

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8–23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

GEN-I Tirana Sh.p.k
Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor,2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor,2015
I. Fluksi i rrjedhës së parasë nga veprimtaritë operative		
Fitimi para tatimit	19	51,356,785
Rregullime për:		174,704,599
Amortizimi dhe zhvlerësimi	7	152,409
Provigjione	16	4,907
Shpenzime për interesa (Fitime) / Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	18	234,029
	18	213,424
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues	51,961,554	81,147,212
<i>Levizje ne kapitalin punues:</i>		
Rënie në llogarite e arkëtueshme (Rritje) / rënie në llogaritë e arkëtueshme të tjera	1,882,197,637	624,618,850
(Rënie) / rritje në llogaritë e pagueshme	(137,743,948)	25,734,422
(Rënie) / rritje në detyrime të tjera	(1,196,719,594)	306,260,599
	(46,909)	98,897
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë operative		
Interesi paguar	(443,211)	(432,998)
Tatim fitimi i paguar	-	-
Rjedha neto e mjeteve monetare e (përdorur) / gjeneruar në veprimtaritë operative	599,205,529	(211,810,718)
II. Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e investimit		
Shitja e aktiveve afatgjata	-	-
Blerja e aktiveve afatgjata	-	-
Blerja e aktiveve jomateriale	-	-
Rjedha neto e mjeteve monetare të përdorur në veprimtarinë e investimit	-	-
III. Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e financimit		
Ripagim i huasë	(204,547,200)	204,547,200
Dividentë te paguar	(163,122,349)	(58,725,175)
Rjedha neto e mjeteve monetare e përdorur në veprimtarinë financuese	(367,669,549)	145,822,025
IV. Rënie neto e mjeteve monetare	231,535,980	(65,988,693)
V. Mjete monetare në fillim të vitit	4,475,605	70,464,297
VI. Mjete monetare në fund të vitit	236,011,585	4,475,605

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-23 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. Informacion i përgjithshëm

GEN- I Tirana Sh.p.k (në vijim referuar si “Shoqëria”) është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më 13 shkurt 2008 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me numër identifikimi K81413005A. Ortaku i vetëm i Shoqërisë është GEN-I d.o.o (shoqëria mëmë). Zyrat kryesore të Shoqërisë janë në Tiranë, Rruga “Ismail Qemali” nr.27. Shoqëria ka hapur një degën të re në Kosovë në dhjetor 2010.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është shitja me shumicë e energjisë elektrike. Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Igor Koprivnikar.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 është 3 (31 dhjetor 2015: 3 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Baza e përpuethshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) në bazë të Ligjit Nr. 9228, datë 29 prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” (ndryshuar).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat e konsoliduara financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Në përputhje me Ligjit Nr. 9228, datë 29 prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” (ndryshuar), këto pasqyra të konsoliduara financiare janë përgatitur në Lekë shqiptar (LEK), e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë .

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave të konsoliduara financiare kërkon nga Drejtimi të ushtrijë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat e konsoliduara financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave të konsoliduara financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra të konsoliduara financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat që paraqiten në keto pasqyra të konsoliduara financiare.

(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhim)

3.1 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejte rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi këmbimi me datë 31 dhjetor 2016 është 135.23 Lekë/Euro.

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbehen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Dega bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Degës mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Dega transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Dega angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Degës skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë paranë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra. Për qëllimin e pasqyrës së konsoliduar të rrjedhës së parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara e parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhena

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhim)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(I) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur perfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(II) Kostot e mëparshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Dega do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në menyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin

(III) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Zhvlerësimi

(I) Aktive financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normen efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rendësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhim)

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

(I) Aktive financiare (vazhdim)

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(II) Aktive jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Degës, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitim

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe shpenzimeve dhe është bazuar në shumën e tatim fitimit të pagueshëm mbi bazën e fitimit të tatueshëm sic përcaktohet në rregullat përkatëse statutoare të kontabilitetit.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrat financiare të konsoliduara, sepse permban zëra të të ardhurave apo shpenzimeve të cilat janë të tatueshme ose të zbritshme në vite të tjera, si edhe përjashton, zëra të cilat nuk konsiderohen asnjëherë të tatueshëm apo të zbritshëm.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Shuma e tatimit të shtyrë e dhënë është bazuar në mënyrën e pritshme të realizimit ose shlyerjes së vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e bilancit.

(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)

3.9 Konsolidimi

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë ato pasqyra në të cilat aktivet, detyrimet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe rrjedha e parasë e shoqërisë mëmë dhe e filialeve të saj janë të paraqitura si një entitet ekonomik i vetëm.

Konsolidimi kërkohet kur shoqëria mëmë (një entitet që kontrollon një ose më shumë entitete të tjera) ka kontroll mbi një shoqëri tjetër. Një shoqëri kontrollon një tjetër kur shoqëria mëmë zotëron direkt ose indirekt (përmes shoqërive të kontrolluara prej saj) më shumë se gjysmën e të drejtave të votës së shoqërisë që po kontrollohet, përvec rasteve ku mund të jetë e parashtruar moszbatimi i kontrollit. Kontrolli ekziston gjithashtu edhe kur shoqëria mëmë zotëron gjysmën ose më pak se gjysmën e të drejtës së votës kur:

- a) zotëron të drejta vote më shumë se gjysma , përmes një marrëveshjeje me investitorë të tjerë.
- b) ka fuqinë të drejtojë politikat financiare dhe operative të Shoqërisë, sipas statutit të marrëveshjes.
- c) ka fuqinë të caktojë ose largojë antarë të manaxhimit dhe të një hierarkie më të lartë supervizuese (psh. bordi manaxhues dhe supervizues i Shoqërisë)
- d) ka fuqinë të udhëheqë vendimet e manaxhimit për të procesuar më tej.

Parimet e kontabilitetit të aplikuara në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare janë të njëjtat parime të aplikuara në përgatitjen e pasqyrave financiare të ndara të Shoqërisë.

Pasqyrat e konsoliduara financiare duhet të ndjekin procedurat e mëposhtme për konsolidim:

- kombinimin e aktiveve, detyrimeve, kapitalit, të ardhurave, shpenzimeve dhe rrjedhës së parasë të shoqërisë mëmë me ato të filialeve.
- eliminojë shumën e investimit të shoqërisë mëmë tek filialet dhe porcionin e kapitalit tek secili filial.
- eliminojë plotësisht aktivet dhe detyrimet, kapitalin, të ardhurat, shpenzimet dhe rrjedhën e parasë brënda grupit lidhur me transaksionet midis entiteteve të grupit (fitime dhe humbje rezultuar nga transaksione brënda grupit të cilat janë të njohura në aktive si psh inventarët dhe aktivet fikse, janë plotësisht të eliminuara)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Arka	-	-
Lek	-	-
Valutë e huaj	-	-
Banka	236,011,584	4,475,605
Lek	1,271,249	1,964,961
Valutë e huaj	234,740,335	2,510,644
TOTALI	<u>236,011,584</u>	<u>4,475,605</u>

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Të arkëtueshme nga palët e treta	322,598,692	2,261,989,663
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	59,541,406	2,343,165
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(60,333,020)	(60,328,113)
TOTAL	<u>321,807,078</u>	<u>2,204,004,715</u>

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e treta konsistojnë në të drejta ndaj klientëve në lidhje me shitjen e energjisë. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme është krijuar interes dhe për penalitete për ditëvonesa.

Shtesa e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Provizionimi për shpenzime interesi	102,640	2,012,078
Provizionim për mos realizim kontrate	-	-
Rimarrje provigjioni	(97,733)	(99,785,587)
TOTALI	<u>4,907</u>	<u>(97,773,509)</u>

6. Llogari të tjera të arkëtueshme

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
TVSH e arkëtueshme	497,020,386	338,959,044
Tatim fitimi i arkëtueshëm	63,921,897	81,283,585
Shpenzime të shtyra	21,168,807	24,124,513
TOTALI	582,111,091	444,367,142

Tatim fitimi i arkëtueshëm përbëhet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Gjëndja e tatim fitimit në fillim të periudhës	81,283,585	129,898,389
Parapagime të bëra gjatë vitit		-
Rimarrje e tatim fitimit sipas akt kontrolli	(8,211,837)	(37,032,554)
Detyrimi për tatim fitimin	(9,149,851)	(11,582,250)
Tatim fitimi i arkëtueshëm	63,921,897	81,283,585

7. Aktive afatgjata materiale

Llogaritë e aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Licencë	Mjete dhe Pajisje	Mobilje zyre	Aktive të tjera materiale	Totali
<i>Kosto</i>					
Më 1 janar 2015	688,050	116,815	729,148	93,352	1,627,365
Shtesa	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	688,050	116,815	729,148	93,352	1,627,365
Shtesa	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2016	688,050	116,815	729,148	93,352	1,627,365
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Më 1 janar 2015	(516,040)	(83,531)	(294,857)	(39,581)	(934,009)
Shtesa	(103,208)	(11,226)	(86,858)	(10,754)	(212,046)
Më 31 dhjetor 2015	(619,248)	(94,757)	(381,715)	(50,335)	(1,146,055)
Shtesa	(68,803)	(5,514)	(69,486)	(8,603)	(152,407)
Më 31 dhjetor 2016	(688,050)	(100,271)	(451,201)	(58,938)	(1,298,461)
<i>Vlera neto</i>					
Më 31 dhjetor 2015	68,803	22,058	347,433	43,017	481,310
Më 31 dhjetor 2016	-	16,544	277,947	34,414	328,903

GEN-I Tirana Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)***8. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	1,031,078,724	2,197,652,366
Të pagueshme ndaj palëve të treta	23,584,589	52,531,683
Fatura të pambërritura	269,289	468,147
TOTALI	<u>1,054,932,602</u>	<u>2,251,652,196</u>

Të pagueshme ndaj palëve të treta janë shuma të pagueshme për Gen-I doo të lidhura kryesisht me blerjen e energjise elektrike gjatë vitit 2016.

9. Të pagueshme ndaj personelit

Të pagueshme ndaj personelit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Të pagueshme ndaj personelit	18,871,671	18,979,473
TOTALI	<u>18,871,671</u>	<u>18,979,473</u>

10. Të pagueshme ndaj shtetit

Të pagueshme ndaj shtetit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Tatim mbi të ardhurat personale	185,742	220,537
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	99,386	111,395
Tatim në burim	45,553	12,752
TOTALI	<u>330,681</u>	<u>344,684</u>

11. Kapitali i Shoqërisë

Shoqëria ka shpërndarë dividendë gjatë 2016 me vlerë 154.9 milion Lek. Rezerva nga rivleresimi është krijuar nga konvertimi i llogarive të ardhurave dhe shpenzimeve nga Euro në Lek të degës në Kosovë.

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Kapitali i shoqërisë	6,050,000	6,050,000
Rezerva nga konvertimi në monedha të huaja	20,564	11,414
Fitimi i akumuluar	8,200,000	8,200,000
Fitimi i vitit	51,356,785	163,122,349
Totali	<u>65,627,349</u>	<u>177,383,762</u>

GEN-I Tirana Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***12. Të ardhura nga shitja e energjisë**

Të ardhurat nga shitja e energjisë gjatë vitit 2016 dhe 2015 rezultojnë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shitje energjie brenda vendit	1,676,386,363	3,857,903,424
Shitje energjie jashtë vendit	1,013,094,431	868,602,637
Tarifë Shërbimi	37,858,149	523,461,715
TOTALI	<u>2,727,338,943</u>	<u>5,249,967,776</u>

13. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera gjatë vitit 2016 dhe 2015 rezultojnë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Disbalanca	198,387	16,177,957
Të ardhura të tjera	3,635,505	2,216,913
TOTALI	<u>3,833,892</u>	<u>18,384,870</u>

14. Materiale të konsumuara

Shpenzimet për blerje energjie gjatë vitit 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Blerje energjie	2,236,278,988	4,388,646,048
Shërbim për transmetim kapaciteti	409,393,619	773,160,922
TOTALI	<u>2,645,672,607</u>	<u>5,161,806,970</u>

15. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit gjatë vitit 2016 dhe 2015 janë përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Paga	9,775,394	10,765,818
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	713,550	731,645
TOTALI	<u>10,488,944</u>	<u>11,497,463</u>

GEN-I Tirana Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***16. Provigjone**

Shpenzimet e provigjionimeve janë përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Provigjione për shpenzime interesi	102,640	2,012,078
Rimarrje provigjioni	(97,733)	(99,785,587)
TOTALI	4,907	(97,773,509)

Gjatë vitit 2016 Shoqëria ka rimarrë nga provigjionet vlerën 97.733 Lekë dhe ka krijuar provizion vlerën 102.640 lekë per shpenzime interesi.

17. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera janë përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime Manaxhimi	5,781,055	8,227,465
Shërbim ligjor	4,910,084	4,324,953
Shërbim konsulence	3,010,653	2,627,345
Qira	1,514,272	1,103,776
Komisione bankare	679,035	1,166,312
Shpenzime Auditi	611,838	-
Shërbim interneti	295,982	367,477
Shërbime telekomunikacioni	278,580	190,342
Shërbim agjencie doganore	232,500	189,900
Tatime të tjera	270,690	143,873
Shërbim përkthimi	177,000	508,000
Shërbime udhëtimi	64,462	175,869
Shpenzime Postare dhe Telekomunikimi	32,347	
Shërbime noteriale	13,000	21,000
Blerje kancelarie	12,083	28,307
Gjoha dhe dëmshpërblime	10,000	-
Shpenzime akomodimi	-	77,118
Shërbime të tjera	-	71,600
Shpenzime të tjera	898,603	62,658
TOTALI	18,792,183	19,285,996

18. Të ardhura financiare neto

Të ardhurat / shpenzime financiare – neto janë përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime interesi	(234,058)	(432,998)
Të ardhura nga interesi	29	44,467
TOTALI	(234,029)	(388,531)
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2015
Fitime të përealizuara nga shkëmbimet valutore	14,202,992	34,323,477
Fitime të realizuara nga shkëmbimet valutore	6,128,557	6,964,166
	20,331,549	41,269,643
Humbje të përealizuara nga shkëmbimet valutore	(13,989,568)	(30,707,931)
Humbje të realizuara nga shkëmbimet valutore	(1,663,101)	(8,802,263)
	(1,663,101)	(39,510,194)
TOTALI	4,678,880	(1,759,449)

19. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri, norma e tatim fitimit është 15% për 2016 (2015: 15%). Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që vlerësohen nga autoritetet tatimore. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është i përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitimi përpara tatimit	60,937,400	174,988,508
Shpenzimet e pazbritshme	61,610	101,797,665
Shpenzime provigjoni	4,907	99,785,587
Penalitete, gjoba	10,000	-
Shpenzime të tjera të pazbritshme	46,703	2,012,078
Totali i shpenzimeve të pazbritshme	61,610	2,012,078
Fitimi i tatueshëm	60,999,010	77,214,999
Shpenzimi i tatim fitimit 15%	9,149,851	11,582,250

20. Palët e lidhura

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është fuqia për të drejtuar politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë që të marrë përfitime nga veprimtaritë e saj. Kontrolli supozohet të ekzistojë, kur prindi, zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të filialit.

Përmbledhja e transaksioneve me palët e lidhura është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Aktive		
Të arkëtueshme nga Gen-I doo	59,541,406	2,343,165
Detyrime		
Të pagueshme ndaj Gen-I Beograd	-	-
Të pagueshme ndaj Gen-I doo	1,031,078,724	2,197,652,366
Të ardhura		
Shitje ndaj Gen-I doo	1,020,620,906	1,333,567,153
Shpenzime		
Materiale të konsumuara nga Gen-I Beograd	-	849,217,218
Materiale të konsumuara nga Gen-I Athens	9,052,911	-
Materiale të konsumuara nga Gen-I Sllovenia	1,266,059,682	2,764,424,054

21. Manaxhimi i rrezikut financiar

a) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normave të interesit përbën rrezikun e luhatjeve të vlerave të instrumentave financiarë si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave, në lidhje me aktivet ndryshojnë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar Shoqëria. Aktivet dhe pasivet e Shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

b) Rreziku i kredisë

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, ndaj nuk ka ndikim në pozitën dhe performancën e saj financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.

GEN-I Tirana Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave të konsoliduara financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)***21. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****c) Rreziku i likuiditetit**

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të rëndësishme ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare janë të kufizuara vetëm në llogaritë e pagueshme në rrjedhën normale të biznesit dhe të pagueshme ndaj furnitoreve. Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2016 është paraqitur më poshtë:

Më 31 dhjetor 2016	Vlera mbartur	Deri në 3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet
<i>Aktive financiare</i>				
Mjete monetare	236,011,584	236,011,584	-	-
Llogari të arkëtueshme	321,807,078	261,474,058	-	60,333,020
Llogari të tjera të arkëtueshme	582,111,090	146,481,782	208,177,183	227,452,125
Totali	1,139,929,752	643,967,424	208,177,183	287,785,145
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme	1,054,932,602	390,628,739	664,303,863	-
Llogari të tjera të pagueshme	19,698,701	679,963	0	19,018,738
Totali	1,074,631,303	391,308,702	664,303,863	19,018,738
<i>Pozicioni neto i likuiditetit</i>	65,298,449	252,658,722	(456,126,680)	268,766,407

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2015 është paraqitur më poshtë:

Më 31 dhjetor 2015	Vlera mbartur	Deri në 3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet
<i>Aktive financiare</i>				
Mjete monetare	4,475,605	4,475,605	-	-
Llogari të arkëtueshme	2,204,004,715	2,097,400,608	-	106,604,107
Llogari të tjera të arkëtueshme	444,367,142	8,737,834	208,177,183	227,452,125
Total	2,652,847,463	2,110,614,047	208,177,183	334,056,232
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme	(2,251,652,196)	(1,647,283,848)	(604,219,095)	(149,253)
Llogari të tjera të pagueshme	(224,292,810)	(205,263,125)	(766,138)	(18,263,547)
Totali	(2,475,945,005)	(1,852,546,973)	(604,985,233)	(18,412,800)
<i>Pozicioni neto i likuiditetit</i>	176,902,458	258,067,074	(396,808,050)	315,643,433

(Të gjitha shumat në Lek, përvecse kur shprehet ndryshe)

21, Menxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku nga kursi i këmbimit

Ekspozimi ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është paraqitur më poshtë:

Më 31 dhjetor 2016	Vlera e mbartur	Euro	Lek
Mjete monetare	236,011,584	234,740,335	1,271,249
Llogari të arkëtueshme	903,918,168	359,114,782	521,778,070
Llogari të pagueshme	1,054,932,602	1,031,564,972	342,314
Pozicioni neto	84,997,150	(437,709,855)	522,707,005
Më 31 dhjetor 2015			
Mjete monetare	4,475,605	2,510,644	1,964,961
Llogari të arkëtueshme	2,204,972,533	2,261,710,085	56,737,552
Llogari të pagueshme	(2,251,652,196)	(49,174,242)	(2,202,477,954)
Pozicioni neto	(42,204,058)	2,215,046,487	(2,143,775,441)

Gjatë vitit u aplikuan kurset e mëposhtme të këmbimit:

Lek	Kursi mesatar i këmbimit		Kursi i këmbimit në datat raportuese	
	2016	2015	2016	2015
EURO	137.35	139.74	135.23	137.28

Analiza e ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit

Analiza e ndjeshmërisë e paraqitur më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit në valutë të huaj në datën e raportimit dhe ndryshimeve të përcaktuara të ndodhura në fillim të vitit financiar dhe duke mbajtur konstant gjatë periudhës raportuese, Më poshtë është një paraqitje e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi fitimin neto, duke konsideruar të gjitha variablat e tjera konstante:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Euro zhvlerësohet me 10%	(8,499,715)	3,644,598
Euro rivlerësohet me 10%	8,499,715	(3,644,598)

22. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Dega mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë dhe masa ligjore, Vecanerisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të periudhes raportuese, është objekt i interpretimeve të ndryshme për sa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Degës, Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndërmarre nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse, Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit, Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata,

Më 31 dhjetor 2016, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale apo operacionale të kontraktuara por ende të papaguara,

23. Ngjarje pas datës së raportimit

Referuar vendimit të gjykatës së lartë nr. 03116/14, zhvilluar më 20 mars 2017, Gen I Tirana ka fituar çështjen për disbursimin e TVSH-së me vlerë 41,942,621 Lek ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenjë.

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra të konsoliduara financiare.